



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Këshilli Gjyqësor i Kosovës
Sudski Savet Kosova - Kosovo Judicial Council

PANELI PËR LIRIM ME KUSHT
ODBOR ZA USLOVNI OTPUST - CONDITIONAL RELEASE PANEL

RAPORTI VJETOR I PUNËS SË
PANELIT PËR LIRIM ME KUSHT

2023




AKTIVITETET E PANELIT PËR LIRIM ME KUSHT

Me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-132 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, ndër të tjera, ndryshim ka pësuar edhe përbërja e anëtarëve të Panelit, në atë mënyrë që përbërja e panelit tani duhet të jetë prej tre (3) anëtarëve me mandat dy (2) vjeçar, pa të drejtë rizgjedhje dhe anëtarët duhet të jenë: një (1) anëtarë gjyqtarë nga Gjykata Supreme, një (1) anëtarë gjyqtar nga Gjykata e Apelit dhe një (1) zyrtar nga Ministria e Drejtësisë. Ndërsa në vitin 2023, me përfundimin e mandatit të anëtarit nga radha e gjyqtarëve të Gjykatës Themelore në Prishtinë, pas ndryshimeve ligjore sa i përket përbërjes së anëtarëve të panelit, anëtari nga radhët e Gjykatës Themelore Prishtinë është zëvendësuar nga zyrtarja e Ministrisë së Drejtësisë e emëruar nga Ministria e Drejtësisë.


Paneli për lirim me kusht gjatë mbajtjes së seancave dhe analizimit të kërkesave për kualifikim për lirim me kusht, ka marr parasysh kushtet e përcaktuara në Kodin Penal të Republikës së Kosovës, përfshirë kriteret e parashikuara në Rregulloren 01/39 mbi Organizimin dhe Funksonimin e Panelit për Lirim me Kusht. Personi i dënuar mund të lirohet me kusht sipas nenit 90 të KPRK-së, përkatësisht par. 2 i këtij kodit ku parashihet që:

“Personi i dënuar për vepër penale për të cilën është paraparë dënim me të paktën pesë (5) vjet burgim, mund të lirohet me kusht pasi të ketë mbajtur dy të tretat (2/3) e dënimit të shqiptuar. Për vepra tjera penale, personi i dënuar mund të lirohet me kusht pasi të ketë mbajtur gjysmën e dënimit të shqiptuar”. Për personat e dënuar me burgim për të mitur, zbatohen dispozitat e Kodit të Drejtësisë për të Mitur. Pra, lirimi me kusht sipas dispozitave të ligjit është një mundësi dhe jo një masë që duhet të pranohet në mënyrë automatike.

Po ashtu, Paneli gjatë shqyrtimit të kërkesave për lirim me kusht, ka vlerësuar dosjen e të dënuarit, raportet përmbledhëse të përpiluara nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, ashtu siç është përcaktuar në nenin 166 të Ligjit Nr. 08/L-132 mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale dhe Rregullores mbi Organizimin dhe Funksonimin e Panelit për Lirim me Kusht.



Paneli për lirim me kusht nga viti 2022 ka bartur njëqind e dhjetë (110) kërkesa, ndërsa gjatë vitit 2023, paneli ka pranuar edhe shtatëqind e gjashtëdhjetë e dy (762) kërkesa të reja, duke e arritur totalin në tetëqind e shtatëdhjetë e dy (872) kërkesa për shqyrtim. Kjo rritje ka detyruar organizimin e pesëdhjetë e pesë (55) seancave, me ç'rast janë shqyrtuar tetëqind e gjashtëmbëdhjetë (816) kërkesa për lirim me kusht të parashtruara nga të dënuarit përmes institucioneve korrektuese. Lidhur me këto kërkesa të të dënuarve paneli gjatë vitit 2023, ka vendosur si në vijim:



Nga totali prej tetëqind e shtatëdhjetë e dy (872) kërkesa për lirim me kusht, tetëqind e gjashtëmbëdhjetë (816) prej tyre janë shqyrtuar nga ana e panelit, që i bie 93.58% nga totali i kërkesave të pranuar. Nga totali i kërkesave të shqyrtuara, treqind e nëntëdhjetë e pesë (395) prej tyre janë të aprovuara (48.41%), ndërsa treqind e shtatëdhjetë e gjashtë (376) e tyre janë të refuzuara (46.08%). Paneli varësisht nga plotësimi i kushteve të kërkesave ka marr vendime edhe për hedhje të kërkesës, prej të cilave nëntëmbëdhjetë (19) prej tyre janë hedh (2.33%), ndërsa për njëzetë e pesë (25) prej tyre është pushuar procedura për arsye se të njëjtit pas paraqitjes së kërkesës për lirim me kusht, për këta të dënuar gjykatat kanë marr vendim për lirim të parakohshëm nga vuajtja e dënimit. Për këtë vit Paneli ka pasur vetëm një kërkesë e shqyrtuar mirëpo për arsye procedurale është shty për shqyrtim për vitin 2024.


Po ashtu, nga totali tetëqind e gjashtëmbëdhjetë (816) kërkesave, tetë (8) vijnë nga Qendra Korrektuese për Femra dhe dymbëdhjetë (12) nga Qendra Korrektuese për të Mitur. Analiza e këtyre rasteve mund të ofrojë perspektivë më të hollësishme rreth sfidave dhe çështjeve të këtyre dy kategorive në procesin e lirimit me kusht.

Sipas Ligjit Nr. 08/L-132 mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, refuzimi i një kërkesë për lirim me kusht nuk konsiderohet përfundimtar meqë ligji ka paraparë që me rastin e refuzimit të kërkesës për lirim me kusht të caktohet edhe rishqyrtimi, si një masë për t'i dhënë motiv personit të dënuar për rehabilitim dhe risocializim, me synim të ri integritet të tij/saj në familje dhe rrethin shoqëror. Periudha kohore për rishqyrtimin e kërkesave caktohet në aktvendimin e Panelit për Lirim me Kusht dhe kërkesa për rishqyrtim nuk mund të parashtrohet më herët se tre (3) muaj, por jo edhe me gjatë se dymbëdhjetë (12) muaj nga shqyrtimi paraprak.


Hyrja në fuqi e Ligjit Nr. 08/L-132 mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, ka paraparë të drejtën në ankesë nga pala e pakënaqur me vendimin e Panelit për Lirim me Kusht, drejtpërdrejt në Gjykatën Supreme, ku gjatë kësaj periudhe, Paneli ka shqyrtuar dyzetë e nëntë (49) dosje të cilat janë përcjellë me ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës. Kjo tregon se ka pasur një numër të konsiderueshëm të rasteve ndaj të cilave është paraqitur ankesë në instancën më të lartë gjyqësore

Gjatë vitit 2023, Paneli për lirim me kusht ka analizuar me kujdes tetëqind e dyzetë (840) raporte informative nga Shërbimi Sprovues i Kosovës, të cilat kanë ofruar një pasqyrë të detajuar mbi sjelljen dhe përmbushjen e kushteve nga individët e liruar me kusht. Në këtë kontekst, së bashku me raporte informative kemi pranuar edhe kërkesa për udhëtim jashtë vendit të parashtruara nga të liruarit me kusht, Paneli ka aprovuar tridhjetë (30) kërkesa për udhëtim jashtë vendit, ndërsa pesë (5) kërkesa i ka refuzuar.

Në lidhje me mos përmbushjen e obligimeve nga të liruarit me kusht, Paneli ka marrë masën e revokimit të gjashtëmbëdhjetë (16) aktvendimeve të mëparshme. Kjo shënon një reagim të menjëhershëm në rastet kur individët nuk kanë respektuar detyrimet e vendosura nga paneli.



Gjatë vitit 2023, Paneli për Lirim me Kusht ka arritur të rrisë numrin e vendimeve të publikuara në faqen zyrtare të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për 87%, krahasuar me vitin 2022.



Duke pasur parasysh transparencën dhe njoftimin e publikut lidhur me punën e panelit, i njëjti ka publikuar nëntëqind (900) aktvendime në faqen zyrtare të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), gjatë vitit 2023. Veprim ky i cili thekson përkushtimin e panelit për të bërë procesin e vendimmarrjes më të qartë dhe të kuptueshëm për publikun.

Ndërsa edhe për gjatë vitit 2023, paneli ka vazhduar me dhënien e përgjigjeve drejtuar personave të autorizuar të të dënuarve që gjenden në vuajtje të dënimit në institucione korrektuese lidhur me kërkesat e tyre për informacion në formë elektronike përmes zyrës për informim të mediave të KGJK-së dhe parashtresave fizike të pranuar nga paneli.

Në takimin 318 të KGJK-së është miratuar Rregullorja Nr. 12/2023 për Punën e Panelit për Lirim me Kusht, e cila ka synimin të ofroj udhëzime të nevojshme për të gjithë pjesëmarrësit në procedurën e lirit me kusht, si dhe ndryshimet e fundit ligjore, përkatësisht miratimi i ligjit të ri për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale ka bërë të domosdoshme rishikimin e rregullores aktuale dhe qartësimin e udhëzimeve për Panelin, Institucionet Korrektuese, dhe Shërbimin Sprovues, me synimin për të përmirësuar zbrazëtirat procedurale dhe për të siguruar plotësimin efektiv të detyrave të tyre.

Me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe trajtimin profesional të kërkesave sipas standardeve ndërkombëtare për të dënuarit, të cilët përmbushin kushtet që çështja e tyre të trajtohet nga Paneli, është pa e nevojshme, ndër të tjera të ndryshohen dy çështje me rëndësi në rregullore:

- Afati për paraqitjen e kërkesës për lirim me kusht dhe kërkesës për rishqyrtim ku nga 30 ditë është shkurtuar në 7 ditë dhe
- Afati për shqyrtimin e kërkesës nga ana e Panelit nga 3 muaj në 2 muaj.

Ndryshimi i paraparë në rregulloren e miratuar në KGJK, do të ketë impakt edhe në numrin e kërkesave që do të barten vit pas viti për shkak të ndryshimit të afateve në paraqitjen e tyre për shqyrtim dhe rishqyrtim.

Po ashtu, me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-194 për Sistemin Qendror të Evidencës Penale të Kosovës, sistem ky që mirëmban bazën e të dhënave për regjistrat e dënimeve, është paraparë obligim për panelin që të gjitha aktvendimet aprovuese për lirim me kusht, të regjistrohen në sistemin e evidencës penale.

Duke marr parasysh faktin se paneli merr vendime edhe për revokim të lirimit me kusht, në rregulloren e miratuar me 21 dhjetor 2023, ka paraparë që përveç aktvendimeve aprovuese t'i bart për regjistrim në sistemin e evidencës penale edhe aktvendimet revokuese për personat e liruar me kusht.

BASHKËPUNIMI ME SHËRBIMIN KORREKTUES TË KOSOVËS

Me qëllim të bashkëpunimit me Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe rritjen e efikasitetit dhe profesionalizmit në trajtimin e kërkesave për lirim me kusht, Paneli gjatë vitit 2023 ka mbajtur takime me Drejtorin e Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe Drejtorët e Institucioneve Korrektuese, me ç'rast ka rezultuar edhe në vizita të Panelit në institucione korrektuese. Këto vizita kanë ofruar një mundësi për Panelin për të vlerësuar në terren se si zbatohen rregulloret dhe standardet, si dhe për të bërë një vlerësim të situatës së përgjithshme në këto ambiente.

Vizitat e Panelit për Lirim me Kusht në institucione korrektuese paraqesin një aspekt kryesor të përfshirjes dhe monitorimit të veprimtarisë së tij. Gjatë këtyre vizitave, Paneli ka pasur për qëllim të zhvillojë një vlerësim të drejtë dhe të pavarur të kushteve, trajtimit dhe të drejtave të të dënuarve në këto institucione.

Gjatë këtyre vizitave, Paneli ka pasuar një qasje të hollësishme ndaj realitetit të institucioneve korrektuese, duke diskutuar me stafin përkatësisht me zyrtarët social dhe korrektues dhe duke shqyrtuar dokumentacionin relevante. Ky proces i vlerësimit në terren ka bërë të mundur për Panelin të identifikojë çështje konkrete, të diskutojë sfidat dhe të propozojë masat e nevojshme përmirësuese.

Vizitat në institucione korrektuese kanë shërbyer si një mjet efektiv për të mbikëqyrur dhe vlerësuar zbatimin e rregullave dhe procedurave, duke kontribuar kështu në garantimin e një trajtimi të drejtë dhe të rregullt të individëve të dënuar. Ky proces gjithashtu promovon transparencën dhe përgjegjshmërinë ndaj publikut, duke e bërë Panelin një mekanizëm efikas të mbikëqyrjes në fushën e drejtësisë penale në Kosovë.

BASHKËPUNIMI ME SHËRBIMIN SPROVUES TË KOSOVËS

Bashkëpunimi me Shërbimin Sprovues të Kosovës është një aspekt tjetër kyç i funksionimit të Panelit për lirim me kusht. Gjatë vitit 2023, ky bashkëpunim ka përfshirë shqyrtimin e 840 raporteve fillestare, periodike dhe përfundimtare, duke përfshirë kërkesat e tjera të parashtruara nga të liruarit me kusht përmes Shërbimit Sprovues të Kosovës. Ky bashkëpunim ka shërbyer si burim i rëndësishëm i informacionit për panelin, duke ofruar një perspektivë të hollësishme mbi sjelljen dhe përmbushjen e kushteve nga individët të cilëve ju është aprovuar kërkesa për lirim me kusht.

Bashkëpunimi i vazhdueshëm me Shërbimin Sprovues është kritik për sigurimin e një analize të plotë dhe të drejtë të situatave të ndryshme, duke kontribuar në përmirësimin e procesit të lirimit me kusht.

Sfidë e panelit dhe e Shërbimit Sprovues njëkohësisht mbetet lirimi me kusht i personave me shtetësi të huaj, të cilët kanë plotësuar kushtet për lirim me kusht.

Gjatë vitit 2023, paneli ka pasur kërkesa kryesisht nga shtetasit e Republikës së Shqipërisë për transfer të mbikëqyrjes nga Shërbimi Sprovues i Kosovës në Shërbimin e Provës së Republikës së Kosovës, që përkundër marrëveshjes për bashkëpunim juridik ndërkombëtar për këto çështje, e njëjta në praktikë nuk po gjen zbatim. Prandaj, nga ana e Panelit si në takim me Ministren e Drejtësisë ashtu edhe përmes përfaqësuesit të Ministrisë së Drejtësisë, përkatësisht anëtarit të panelit, është dhënë rekomandim që të rishikohet kjo marrëveshje në aspektin praktik të saj.